**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**

# V E N D I M

## PËR LIRIMIN DHE EMËRIMIN E DY ANËTARËVE TË KZAZ NR. 12, TË NJË ANËTARI TË KZAZ NR. 13 DHE TË NJË ANËTARI TË KZAZ NR. 21 PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE, TË DATËS 30 QERSHOR 2019

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në mbledhjen e tij të datës 01.06.2019, me pjesëmarrjen e:

| | | |
|---|---|---|
| Klement | ZGURI - | Kryetar |
| Denar | BIBA - | Zv/Kryetar |
| Bledar | SKËNDERI- | Anëtar |
| Edlira | JORGAQI- | Anëtare |
| Rezarta | BITRI- | Anëtare |

shqyrtoi çështjen me:

**OBJEKT:** Lirimin dhe emërimin e dy anëtarëve të KZAZ nr. 12, të një anëtari të KZAZ nr. 13 dhe të një anëtari të KZAZ nr. 21 për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 30 qershor 2019.

**BAZA LIGJORE:** Neni 23, pika 1, gërma "a", neni 30, neni 31, neni 32, pika 2 gërma "d", të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë.

KQZ pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur dhe dëgjoi diskutimet e të pranishmëve,

## V Ë R E N

Partia Socialiste e Shqipërisë, bazuar në nenin 32, pika 2, germa "d", të Kodit Zgjedhor, ka kërkuar:

- lirim të anëtares të KZAZ nr.12, zj. Nertila Nika dhe emërim të zj. Blerina Ndoja, Bashkia Lezhë, me shkresën nr. 4999 prot., datë 30.05.2019;
- lirim të anëtarit të KZAZ nr. 12, z. Ernest Ndreca dhe emërim të z. Fation Gjoni, Bashkia Lezhë, me shkresën nr. 4999 prot., datë 30.05.2019;
- lirim të anëtares të KZAZ nr. 13, zj. Simonela Florini dhe emërim të zj. Elona Ndrecaj, Bashkia Lezhë, me shkresën nr. 4971 prot., datë 29.05.2019;

- lirim të anëtares të KZAZ nr. 21, zj. Klementina Meçi dhe emërim të zj. Heroinë Duka, Bashkia Durrës, me shkresën nr. 5035 prot., datë 31.05.2019;

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, pasi shqyrtoi kërkesat dhe propozimet e paraqitur nga Partia Socialiste e Shqipërisë, e gjen në përputhje me kërkesat e nenit 30, 31 dhe 32 të Kodit Zgjedhor.

**PËR KËTO ARSYE**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve bazuar në nenin 23, pika 1, gërma "a", nenin 30, nenin 31, nenin 32, pika 2 gërma "d", të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë.

**V E N D 0 S I:**

1. Të lirojë nga detyra anëtarët e KZAZ nr. 12, zj. Nevila Nika dhe z. Ernest Ndreca, anëtaren e KZAZ nr. 13, zj. Simonela Florini, Bashkia Lezhë, anëtaren e KZAZ nr. 21, zj. Klementina Meçi, bashkia Durrës.

2. Të emërojë anëtarët e KZAZ nr. 12, zj. Blerina Ndoja dhe z. Fation Gjoni, anëtaren e KZAZ nr. 13, zj. Elona Ndrecaj, Bashkia Lezhë, anëtaren e KZAZ nr. 21, zj. Heroinë Duka, Bashkia Durrës.

3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, brenda pesë ditëve nga shpallja e tij.

| | | |
|---|---|---|
| **Klement** | **ZGURI -** | **Kryetar** |
| **Denar** | **BIBA -** | **Zv/Kryetar** |
| **Bledar** | **SKËNDERI-** | **Anëtar** |
| **Edlira** | **JORGAQI-** | **Anëtare** |
| **Rezarta** | **BITRI** | **Anëtare** |